

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6543
E enjte, 24 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Ukraina shpall gjendje të jashtëzakonshme

FAQE 6-7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

EDHE NJË TAKIM NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË NË BRUKSEL
PËRFUNDON PA MARRËVESHJE | FAQE 4-5

LAJÇAKU: JEMI AFËR ARRITJES SË MARRËVESHJES PËR DISA DOKUMENTE



Përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së një marrëveshjeje në lidhje me disa dokumente. "Pas 11 orësh negociata intensive, jemi afër arritjes së një marrëveshjeje për disa dokumente. Por shpesh hapi i fundit është më i vështiri. Puna vazhdon", ka bërë me dije Lajçak

Rritja e çmimeve në Shqipëri, presidenti Meta bën thirrje për rritjen e pagave

FAQE 3



KOSOVA DHE SHQIPËRIA, MARRËVESHJE PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE

FAQE 5

AKTUALE



TRE TË VDEKUR DHE 257 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 7

TAKOHEN TOTAJ DHE MINXHOZI: TË RRIET BASHKËPUNIMI NË TURIZËM DHE ZHVILLIM EKONOMIK

F. 7

QEVERIA NUK LËVIZ NGA NDALESA PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE TË SERBISË NË KOSOVË

F. 7

EKONOMI



SZUNYOGI: KOSOVA T'I SHQYRTOJË MUNDËSITË E REJA PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE

F. 8

NDAHEN 10 MILIONË EURO PËR REZERVAT SHETËTËRORE, PËRFSHIHEN NË PAKON E RINGJALLJES EKONOMIKE

F. 8

SPORT



GIRESE: JAM I NDERUAR QË DO TA DREJTOJ KOSOVËN

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina shpall gjendje të jashtëzakonshme

KIEVI, 23 SHKURT - Një zyrtar i lartë i sigurisë në Ukrainë, Oleksiy Danilov, ka thënë të mërkurën se Ukraina ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme në të gjithë territorin e saj, përveç rajoneve Donetsk dhe Luhansk, ku gjendja emergjente është e vendosur nga viti 2014. Ai ka thënë se gjendja e jashtëzakonshme do të zgjasë 30 ditë dhe mund të zgjatet edhe për 30 ditë të tjera.

Separatistët pro-rusë kanë kontrolluar pjesë të Donetskut dhe Luhanskut që nga viti 2014. Rusia i njohu ato si shtete të pavarura dhe miratoi dërgimin e trupave të saj atje gjatë kësaj jave.

Danilov ka theksuar se presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, nuk kishte diskutuar zhvillimin e armëve bërthamore, diçka që presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se përbën një kërcënim strategjik për Rusinë. Ukraina po përballet me atë që Perëndimi thotë se është kërcënim i një pushtimi të afërt në shkallë të plotë nga Rusia.

Presidenti rus Vladimir Putin këtë javë njohu pavarësinë e dy rajoneve separatiste në Ukrainën lindore dhe tha se do të dërgonte trupa ruse në këto territore, lëvizje të dënuara nga Perëndimi dhe Kombet e Bashkuara.

Ndërkohë, Ukraina ka deklaruar se po thërret rezervistët ushtarakë të moshës 18-60 vjeç për një vit shërbimi, por se nuk po urdhëron një mobilizim të përgjithshëm të trupave në këtë kohë.

Ukraina u kërkon qytetarëve të saj të largohen nga Rusia

Ukraina po u kërkon qytetarëve të saj që t'i shmangin udhëtimet në Rusi dhe që ata që janë atje të largohen menjëherë, duke përmendur një ndërprerje të mundshme të shërbimeve konsullore përballë tensioneve në rritje me Rusinë. "Për shkak të përshkallëzimit të agresionit rus kundër Ukrainës, i cili mund të çojë në një reduktim të konsiderueshëm të asistencës së mundshme konsullore në Rusi, Ministria e Jashtme u bënë thirrje



qytetarëve të Ukrainës që të përmbahen nga udhëtimi në Rusi dhe që ata në atë vend të largohen menjëherë nga territori i saj", ka bërë me dije kjo ministri në një deklaratë lëshuar të mërkurën.

Sipas shifrave të regjistrimit rus, rreth 1.9 milion ukrainas jetojnë në Rusi që nga viti 2010, me shumë familje të përziera të ukrainasve dhe rusëve.

Ukraina po përballet me atë që Perëndimi thotë se është kërcënim i një pushtimi të afërt në shkallë të plotë nga Rusia.

Ukraina ka deklaruar se po thërret rezervistët ushtarakë të moshës 18-60 vjeç për një vit shërbimi, por se nuk po urdhëron një mobilizim të përgjithshëm të trupave në këtë kohë.

BE-ja, sanksione ndaj Rusisë

Raundi i parë i sanksioneve të Bashkimit Evropian kundër Rusisë ka hyrë në fuqi të mërkurën ka bërë me dije një diplomat i BE-së.

Një ditë më herët BE-ja ka futur në listë të zezë shumë politikanë rusë dhe ka ndaluar tregtinë midis bllokut dhe dy rajoneve separatiste në lindje të Ukrainës, Donjeck dhe Luhansk, pasi presidenti rus, Vladimir Putin, njohu më 21 shkurt Donjeckun dhe

Luhanskun entitete të pavarura.

BE-ja zgjodhi të mos e sanksionojë vetë Putinin, por të fusë në listën e zezë të gjithë anëtarët e Dhomës së Ulët të Parlamentit rus që votuan në favor të njohjes së rajoneve separatiste si të pavarura. Blloku ngriu çdo pasuri që ata kanë në BE dhe u vendosi ndalesa udhëtimi. Bankat e përfshira në financimin e aktiviteteve separatiste në lindje të Ukrainës janë, gjithashtu, në shënjestër të sanksioneve, ndërsa dy rajonet do të hiqen nga një marrëveshje e tregtisë së lirë midis BE-së dhe Ukrainës. Sanksionet, të miratuara

tashmë në parim nga ministrat e Jashtëm të BE-së, kanë ende nevojë për miratim zyrtar nga ta. Ky është më shumë një formalitet që pritet të ndodhë gjatë ditës së mërkurë dhe sanksionet do të hyjnë në fuqi sapo të publikohen në gazetën zyrtare të BE-së.

Gjermania mund të funksionojë pa gazin rus

Gjermania mund t'i plotësojë nevojat e saj për energji pa gaz rus ka thënë ministri i saj i Ekonomisë të mërkurën, pasi qeveria vendosi ta ndalojë miratimin e gazsjellësit të diskutueshëm, i njohur si Rrjedha Veriore 2, në mes të

tensioneve në rritje në Ukrainë.

Gazsjellësi nënujor e dërgon drejtpërdrejt gazin rus në Evropë përmes Gjermanisë dhe është i kompletuar, por ende nuk funksionon.

I pyetur në radion publike nëse ekonomia më e madhe e Evropës mund të bënte pa furnizime me gaz natyror nga Rusia, aktualisht furnizuesi i saj më i madh, ministri i Ekonomisë, Robert Habeck, u përgjigj: "Po, mundet".

Të martën kancelari Olaf Scholz tha se miratimi i gazsjellësit nga Rusia do të pezullohej në përgjigje të vendimit të presidentit Vladimir Putin për të njohur dy rajone separatiste të Ukrainës. "Shkëputja plotësisht nga gazi rus do të linte një vrimë të madhe në treg që në radhë të parë do t'i 'rriste çmimet'", ka thënë Habeck i Partisë së Gjelbër.

Megjithatë, kërkesat e Gjermanisë për energji mund të "kompensohen" me burime dhe furnizues të tjerë të energjisë, duke përfshirë një shtytje të përshpejtuar të burimeve të rinovueshme të përcaktuara nga qeveria, tha ai.

Gazsjellësi Rrjedha Veriore 2, i cili u përfundua, por nuk u miratua kurrë nga rregullatorët, ishte vendosur ta rriste varësinë e Gjermanisë nga Rusia për gaz në 70 përqind të furnizimeve të saj totale. Është një tubacion gazi natyror, i gjatë 1 230 kilometra, nën Detin Baltik, që shkon nga Rusia drejt bregut baltik të Gjermanisë.



Qeveria nuk lëviz nga ndalesa për mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë

PRISHTINË, 23 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka ripërsëritur qëndrimin e saj në lidhje me ndalesën e mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale të Serbisë brenda territorit të Kosovës. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka theksuar se kjo çështje është rregulluar me ligjet e vendit. "Konsiderojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme të respektohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, por edhe legjislacioni në fuqi", ka thënë ajo në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën.

Serbia mban zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe ato presidenciale më 3 prill. Autoritetet e Serbisë kanë thënë se në dialogun Kosovë - Serbi do të kërkojnë që të lejohet edhe votimi në territorin e Kosovës në zgjedhjet e Serbisë. Megjithatë, në takimin e delegacionit të Kosovës me të dërguarin e posaçëm Miroslav Lajçak më 22 shkurt nuk është folur për këtë temë.

Ministrja Haxhiu ka rikujtuar se Qeveria, Kuvendi dhe Presidenca e Kosovës janë në linjë të njëjtë sa i përket kësaj çështjeje. Sipas Qeverisë së Kosovës, qytetarët e

Kosovës që kanë edhe shtetësi të Serbisë do të mund të votojnë në zgjedhjet e Serbisë "në zyrën ndërlidhëse në Kosovë apo me postë".

Në të kaluarën Serbia ka mbajtur zgjedhjet parlamentare në territorin e Kosovës. Zgjedhjet e fundit u mbajtën më 21 qershor 2020. Në atë kohë fletëvotimet i ka mbledhur misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë. Pas mbylljes së qendrave të votimit, votat nga Kosova janë numëruar në Rashkë dhe Vranjë - dy qytete kufitare të Serbisë. Kjo praktikë e mbledhjes së votave është krijuar në vitin 2017 dhe deri më tani ajo ka pasur lejen e autoriteteve të Kosovës.

Në një deklaratë të dhënë për Radion Evropa e Lirë të mërkurën (23 shkurt), OSBE ka thënë se praktika e mbledhjes së votave nga ky mision "ka qenë gjithmonë e bazuar në marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe pëlqimit të të gjitha institucioneve relevante për një operacion të tillë". "Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdon të jetë i gatshëm për ta kryer mbledhjen e votave nëse



plotësohet ky kusht", thuhet në përgjigjen e tyre

Me metodën e "mbledhjes së votave" në Kosovë janë mbajtur edhe zgjedhjet presidenciale të Serbisë në vitin 2017. Serbia ka

organizuar zgjedhjet e saj presidenciale në Kosovë edhe në vitin 2012.

Zgjedhjet lokale serbe në Kosovë nuk janë organizuar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin

2008, pasi procesi i decentralizimit ka filluar në të njëjtin vit, bazuar në planin e Martti Ahtisaarit. Ky plan është dokumenti mbi bazën e të cilit Kosova e ka shpallur pavarësinë.

Rritja e çmimeve në Shqipëri, presidenti Meta bën thirrje për rritjen e pagave



TIRANË, 23 SHKURT (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se institucionet shtetërore përgjegjëse duhet t'i monitorojnë zhvillimet e inflacionit në Shqipëri dhe të marrin nisma konkrete për rritjen e pagave në formën e indeksimit me qëllim për ta ruajtur nivelin e jetesës së qytetarëve.

Meta me anë të një shkrimi të publikuar në "Facebook" ka bërë me dije se çmimet në Shqipëri vazhdojnë të rriten në nivele shqetësuese, duke dëmtuar seriozisht ekonominë familjare dhe thelluar varfërimin e shqiptarëve. "Në janar 2022 çmimet në total janë rritur në masën 5 për qind, ndërsa të mallrave ushqimore në 9.9 për qind. Ndërkohë, sipas të dhënave të Eurostat-it, Shqipëria ka nivelin më të lartë në rajon në

përqindje të mesatares evropiane. Në kushtet kur rritja e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë vijon pa u ndalur, institucionet shtetërore përgjegjëse jo vetëm duhet t'i monitorojnë zhvillimet e inflacionit, por edhe të marrin nisma konkrete për indeksimin e pagave me qëllim për ta ruajtur nivelin e jetesës së qytetarëve", ka shtuar Meta.

Sipas presidentit, mosreagimi ndaj rritjes së çmimeve nuk është në përputhje me interesin publik, rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe mbrojtjen e tyre nga spekulimet. Indeksi i Çmimeve të Konsumit në Shqipëri është rritur 3.7 për qind në muajin janar, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, duke regjistruar nivelin më të lartë të inflacionit në dekadën e fundit.

Mbahet takimi i komisioneve të përbashkëta të ekspertëve të Kosovës dhe Shqipërisë

Prishtinë, 23 shkurt (ER) - Në ndërtesën e Administratës së Policisë së Kosovës është mbajtur takimi i komisioneve të përbashkëta të ekspertëve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Ky takim është udhëhoqur nga

kolonel Ragip Bunjaku, drejtor i Departamentit për Kufi. Qëllimi i takimit ishte analizimi i ecurisë së zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Fokus i veçantë i diskutimit dhe analizimit ishin marrëveshjet e fundit të nënshkruara ndërmjet dy qeverive gjatë vitit 2021 dhe fillimi i hartimit të protokolleve teknike që rrjedhin nga këto marrëveshje.





EDHE NJË TAKIM TJETËR NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË NË BRUKSEL PËRFUNDON PA MARRËVESHJE

Lajçaku: Jemi afër arritjes së marrëveshjes për disa dokumente

Përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčák, ka thënë se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së një marrëveshjeje në lidhje me disa dokumente. “Pas 11 orësh negociata intensive, jemi afër arritjes së një marrëveshjeje për disa dokumente. Por shpesh hapi i fundit është më i vështiri. Puna vazhdon”, ka bërë me dije Lajčák

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

BRUKSEL, 23 SHKURT - Zëvendëskryeministri për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka zhvilluar takime dypalëshe me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčák. Zyra e Kryeministrit ka njoftuar se në këto takime u diskutua për çështjen e personave të zhdukur me forcë gjatë luftës në Kosovë, për ndjeshmërinë dhe urgjencën e një zgjidhjeje sa më të shpejtë. “U fol për energjinë në kuadër të marrëveshjes ekzistuese. Diskutimet me Bashkimin Evropian në këtë fushë kanë shënuar përparim, megjithatë mbeten ende disa hollësi për t’u trajtuar”, është bërë me dije në njoftimin për medie. Çështje tjetër e diskutimit ishte

edhe ajo e targave të veturave. Sipas qeverisë, grupet teknike kanë filluar t’i finalizojnë propozimet e tyre përfundimtare. “Takimet e grupeve teknike do të vazhdojnë deri në përzgjedhjen përfundimtare të opsioneve sipas standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian”, është theksuar në njoftimin e Zyrës së Kryeministrit. Pas këtyre takimeve përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčák, ka thënë se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së një marrëveshjeje në lidhje me disa dokumente. Në llogarinë në “Twitter”, Lajčák ka thënë se megjithëse janë afër kësaj marrëveshjeje, hapi i fundit shpesh është më i vështiri. “Pas 11 orësh negociata intensive, jemi afër arritjes së një marrëveshjeje për disa dokumente. Por shpesh hapi i fundit është më i vështiri.

Puna vazhdon”, ka shkruar Lajčák. Ndërkaq pala serbe ka thënë se me Lajčakun ka folur për nevojën për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Çështjet e parë që kemi parashtruar ka qenë formimi i Asociacionit. Kanë kaluar nëntë vjet që nga marrëveshja e Brukselit dhe ende jemi në pritje të formimit. Pa Asociacion nuk e di se si mund të ecim tutje dhe të flasim për çështje të tjera. Jemi të gatshëm të bisedojmë. Por ajo që është me rëndësi është të zbatohen të gjitha marrëveshjet”, ka thënë për mediet serbe shefi i delegacionit të Serbisë për dialog, Petar Petković. Ai e ka fajësuar zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimin, për mosmbajtjen e takimit trepalësh. Ndërkaq kryenegociatori i Kosovës, zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, ka mohuar

pretendimet e bashkëbiseduesit të tij nga Beogradi, Petar Petković, se ka refuzuar një takim trepalësh në dialog. Sipas Bislimit, takimi i përbashkët ka pasur për qëllim përgatitjen e takimit të ardhshëm të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. “Kam insistuar që të takohem me Petkovićin, mirëpo duket se për këtë nuk ka qenë e interesuar pala serbe, e cila më pas ka dalë para medieve, duke theksuar se Bislimi ka refuzuar. Kjo do të konfirmohet nga vetë kabineti i Lajçakut”, u ka thënë Bislimi gazetarëve në Bruksel. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësim të BE-së, ka nisur më 2011. Raundi i ri i bisedimeve të 22 shkurtit u zhvillua pas një kohe relativisht të gjatë pa takime, me përjashtim të atyre të ekspertëve për çështjen e targave të veturave. Për këtë çështje është arritur një marrëveshje kalimtare në vjeshtën e vitit të kaluar, por është thënë se në një afat prej gjashtë muajsh duhet të arrihet një marrëveshje afatgjatë.

Burimet diplomatike në Bruksel kanë paralajmëruar se takimet e së martës do të shfrytëzohen për të testuar nëse ka gatishmëri të mjaftueshme mes palëve edhe për një takim të nivelit të lartë mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb, Aleksandër Vuçiq. Të dyja palët kanë thënë publikisht se janë të gatshme për takim të tillë, por BE-ja ka insistuar se nëse ndodh ai, duhet të ketë edhe rezultate konkrete. Në lidhje me procesin e dialogut ka folur edhe analisti politik Ilir Ibrahim, cili ka thënë se zhvillimet e fundit në botë e tregojnë edhe më shkoqur rëndësinë e arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë. Sipas tij, kjo marrëveshje duhet të heqë njëherë e përgjithmonë Serbinë nga Kosova. Ibrahim thotë se me asociacion kjo marrëveshjeje nuk mund të arrihet, por thotë se zgjidhja më e mirë është shkëmbimi i territoreve. “Asociacioni nuk e bën këtë, prandaj shkëmbimi i territoreve është zgjidhja më e

Projektkodi Civil shqetëson bashkësitë fetare dhe komunitetin LGBTI



PRISHTINË, 23 SHKURT - Udhëheqësit e katër bashkësive fetare në Kosovë kanë paralajmëruar se do të nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët lidhur me Projektkodin Civil që pritet të dalë të enjten para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Pjesa e cila besohet se po kontestohet nga bashkësitë fetare është neni i cili i

hap rrugën hartimit të një ligji të veçantë për lejimin e "bashkësive civile" ndërmjet personave të gjinisë së njëjtë. Deklarata pritet të nënshkruhet nga myftiu i Kosovës, Naim Tërnavi, ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, kryetar i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, Femi Cakolli dhe kryetar i Bashkësisë Hebraike të Kosovës, Votim Demiri.

Çfarë parasheh Projektkodi?

Martesa e gjinisë së njëjtë në Kosovë i lejon Kushtetuta, por deri më tani ato nuk janë lejuar me Kodin Civil dhe Ligji për familjen. Në Kushtetutën e Kosovës thuhet "se në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin". Projektkodi Civil thotë se "martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht ndërmjet dy bashkëshortëve të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirisht vendosin që të jetojnë së bashku si burrë e grua". Por, neni i radhës thotë se "bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave me sekse të njëjta janë të lejuara" dhe se kushtet dhe procedura lidhur me këtë rregullohen me ligj të veçantë. Ky paragraf ka nxitur edhe

reagimet e organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e komunitetit LGBTI (Lesbiket, Homoseksualët, Biseksualët, Transgjinatorët dhe Ndërseksualët). Drejtori ekzekutiv i Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD), Arbër Nuhiu, e quan të pakuptueshëm termin "bashkësitë civile" dhe se ky komunitet, thotë ai, nuk do të pranojë një gjë të tillë. "Bashkësitë civile" nuk përkufizohen në legjislacion, duke përfshirë edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo nuk ka kurrfarë rrjedhshmërie dhe ne nuk e dimë se a do të hartohet një ligj i veçantë për këtë çështje. Ne gjithsesi do ta vazhdojmë punën me deputetët e Kuvendit për të zgjidhur këtë problem", thotë Nuhiu për "Radion Evropa e Lirë". Nuhiu ka qenë i pranishëm në grupin punues të Projektkodit dhe tregon se rekomandimet e organizatave joqeveritare kanë

qenë që martesa të definohet midis personave ashtu siç është në Kushtetutë. "Të përdoret termi neutral, që nënkupton të përdoret termi bashkëshortë", thotë Nuhiu. Edhe pse me anë të këtij Projektkodi nuk definohet se çfarë është "bashkësi civile", aty shkruan se "të martuarit dhe partnerët në bashkësi civile gëzojnë të drejta dhe detyra reciproke në bazë të këtij kodi". Në vende perëndimore bashkësitë civile nuk konsiderohen si martesa, por si marrëdhënie e ligjshme ndërmjet dy personave, e cila siguron mbrojtje ligjore për çiftin vetëm në nivel shtetëror. Në Bashkimin Evropian bashkësitë civile lejojnë dy persona që jetojnë së bashku në çift ta regjistrojnë marrëdhënien e tyre me autoritetin publik përkatës në vendbanimin e tyre. Dallimet midis vendeve të BE-së në këtë fushë, po ashtu, ekzistojnë.

Kosova dhe Shqipëria, marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHKURT - Në mbledhjen e së mërkurës të Qeverisë së Kosovës, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka paraqitur për shqyrtim dhe aprovim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile dhe Tregtare, Projektligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Projektligjin për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe Projektligjin për Shërbimin Sprovues të Kosovës. Sa i përket marrëveshjes të cilën e kanë arritur Republika e Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, ministrja Haxhiu bëri me dije se qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike në çështjet civile dhe tregtare në mes të dy vendeve dhe lehtësimi i procedurës ligjore në këtë fushë. Sipas komunikatës së Ministrisë së Drejtësisë, kjo marrëveshje zbatohet për çështjet që përfshijnë procedurat lidhur me

gjendjen civile, çështjet familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet e pronësisë dhe marrëdhëniet e tjera civile apo tregtare të personave fizikë dhe juridikë. Përmes saj adresohen çështjet si: Garantimi i mbrojtës së të drejtave të njeriut si dhe qasja në gjykata dhe organe të tjera, përjashtimi nga legalizimi i dokumenteve, ndihma juridike dhe lirimi nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore dhe fuqia juridike e dokumenteve publike. Sa i përket Projektligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ministrja Haxhiu tha se, ndër të tjera, përmes këtij Projektligji synohet që të bëhet rregullimi ligjor i ekzekutimit të sanksioneve penale, aplikimi i masave të trajtimit të detyrueshëm dhe aplikimi i masës së paraburgimit. Ndryshimet e parapara në këtë Projektligj, përveç të tjerash, Haxhiu tha se kanë ardhur edhe si kërkesa të parashtruara nga organizatat që i kanë monitoruar institucionet korrektuese si dhe kërkesat nga vetë të burgosurit dhe që lidhen me panelin për lirim me kusht, pezullimin e dënimit, ditët e pushimit dhe lirimin e parakohshëm.



Sa i përket Projektligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ministrja Haxhiu tha se përmes tij synohet që të bëhet përcaktimi i statusit, parimet, përgjegjësitë, menaxhimi dhe organizimi i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim, të drejtat ose detyrimet specifike, rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave, zhvillimin profesional dhe nevojat për

trajtime, transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ministrja Haxhiu para kabinetit qeveritar ka paraqitur edhe Projektligjin për Shërbimin Sprovues të Kosovës përmes të cilit, ka thënë Haxhiu, synohet që të bëhet përcaktimi i statusit, parimeve dhe organizimi i përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës, me qëllim të rehabilitimit dhe riintegritimit shoqëror të personave nën

mbikëqyrje, gjithashtu parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik. Derisa ka theksuar rëndësinë e këtyre projektligjeve, ministrja Haxhiu ka shtuar se aprovimi i tyre mundëson funksionimin e gjithëmbarshtëm të institucioneve përkatëse, përfshirë çështjet të cilat janë në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

mirë. Klasa politike kosovare aktuale duhet ta gjejë guximin sikur e kishte gjetur klasa politike në vitin 2018, dhe ta vendosë këtë opsion në tavolinë", ka shkruar Ibrahim në llogarinë e vet në "Facebook".

Bashkimi Evropian (BE) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) vazhdimisht po u bëjnë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ofrojnë qëndrimet për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare. Përfaqësuesi i posaçëm i Shteteve

të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se dialogu ka për synim normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Ai ka thënë ky proces nuk është për statusin e Kosovës, por për

njohjen e ndërsjellë me Serbinë. "Ne kemi qenë shumë të qartë me Qeverinë e Kosovës, se ne presim që të angazhohet plotësisht në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe t'i shohë bisedimet si negociata të vërteta për ta arritur

qëllimin kryesor të saj - që është njohja e ndërsjellë me Serbinë, njohja nga pesë shtetet e BE-së dhe anëtarësimi në të gjitha organizatat ndërkombëtare ku dëshiron të anëtarësohet", ka thënë Escobari.

QËNDRIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NDAJ KËRKESAVE TË SHQIPTARËVE
TË KOSOVËS PËR PAVARËSI 1990-1999 (5)

Diplomatët evropianë e amerikanë u takuan me përfaqësues të UÇK-së në Dragobil më 6 nëntor 1998



Prof. dr. Sabit SYLA

Krahas aktiviteteve të komunitetit ndërkombëtar, në terren gjithnjë e më shumë po faktorizohej UÇK, e cila me ngulm kërkonte të merrte përgjegjësinë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Komuniteti ndërkombëtar e kishte kuptuar se nuk mund të arrihej një zgjidhje pa UÇK-në, prandaj për të kuptuar nga dora e parë qëllimet e luftës çlirimtare, diplomati i rangut të lartë amerikan, Riçard Holbrok, zhvilloi në fund të qershorit 1998 në Junik një takim me përfaqësues të UÇK. Edhe pse Holbrok kishte deklaruar se "... ishte një takim jozyrtar midis përfaqësuesve amerikanë dhe atyre të UÇK-së me qëllim të identifikimit të gjendjes reale në terren...", megjithatë një akti i tillë mund të konsiderohet edhe si njohje e heshtur e UÇK-së nga ShBA-ja.

Pas momentit të cekur më lart, faktori ndërkombëtar gjithnjë e më tepër do të orientohet tek Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, pasi që UÇK-ja ishte forcë reale në terren, e cila nuk mund të anashkalohej as nga faktori ndërkombëtar e as nga Jugosllavia në përpjekjet për ndaljen e luftimeve dhe vendosjen e paqes. Në këtë mënyrë kontaktet midis UÇK dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë do të intensifikohen gjatë nëntorit 1998. Diplomatët evropianë e amerikanë u takuan me përfaqësues të UÇK-së në Dragobil më 6 nëntor 1998, në të cilën UÇK përfaqësohej nga Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja. Këto takime ishin një indikacion i qartë se adresa e bisedimeve me shqiptarët tanimë ishte zhvendosur nga Prishtina në selinë e Shtabit të Përgjithshëm dhe se UÇK tanimë ishte pranuar edhe zyrtarisht si faktor vendimtar për çështjen e Kosovës.

Zgjerimi i territoreve nën kontroll të UÇK dhe kundër ofensiva serbe e gushtit 1998, që u shoqërua me zhvendosjen e një numri të madh civilësh nga

vendbanimet e tyre, bëri që komuniteti ndërkombëtar të angazhohej për ndaljen e luftimeve, si parakusht për zhvillimin e aktiviteteve drejt gjetjes së një zgjidhjeje paqësore. Më 13 tetor 1998 nënshkruhet marrëveshja ku policia e ushtria serbe do të ktheheshin në nivelet e paraluftës, në Kosovë do të vendosej misioni verifikues i OSBE dhe se NATO do të bombardonte Jugosllavinë brenda 96 orësh nëse marrëveshja nuk do të realizohej. Pavarësisht këtij kërcënimi, gjatë periudhës janar-mars 1999 vazhdoi dhuna brutale e forcave serbe kundër civilëve. Mbi 200 000 njerëz u dëbuan nga vatrata e tyre, kurse nga Serbia gjithnjë e më tepër vinin përforsime ushtarake. Kulmi i dhunës serbe ishte masakra e Reçakut, 15 janar 1999, ku u masakruan mbi 45 civilë. Më 20 mars Misioni Verifikues u tërhoq nga Kosova. Ndërkohë në shkurt 1999 kishte filluar punën Konferenca e Rambujesë që për detyrë kishte gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për Kosovën. Bisedimet për bazë kishin projekt propozimet për të ardhmen e Kosovës, të hartuara nga diplomatët Hill dhe Petrisch. Në përbërje të delegacionit të shqiptarëve të Kosovës ishin përfaqësues të UÇK-së dhe të spektrit politik të Kosovës. Delegacioni i Kosovës kryesohej nga përfaqësuesi i UÇK-së, Hashim Thaçi. Teksti i parë i draft marrëveshjes që iu prezantua shqiptarëve dhe serbëve kishte

pesë pika: ndërprerja e menjëhershme e dhunës; tërheqja e menjëhershme e forcave policore e ushtarake jugosllave nga Kosova; stacionimi në Kosovë i një force ushtarake të udhëhequr nga NATO; rikthimi i sigurt i refugjatëve dhe personave të zhvendosur; dhe një zgjidhje politike që përbëhet nga një autonomi e zgjeruar për Kosovën.

Por, propozimi nuk kishte qenë i pranueshëm për dyja palët. Jugosllavia refuzoi praninë e forcave ndërkombëtare, kurse shqiptarët opsionin e autonomisë së zgjeruar të cilin e kishin pasur edhe me Kushtetutën e vitit 1974. Kërkesa e spektrit politik shqiptar ishte pavarësia, pasi që dhuna brutale serbe prej disa dekadave nuk kishte lënë hapësirë për shqiptarët që të jetojnë nën ombrellën e shtetit serb.

Më 15 mars 1999 rifilluan bisedimet, që ishin ndërprerë për shkak të mospajtimeve. Teksti i ri i negociatave ofronte një autonomi të zgjeruar që përmbante një vetëqeverisje për gjitha çështjet e brendshme, si: arsimit, shëndetësia dhe ekonomia. Kosova do të kishte presidentin dhe kuvendin, gjykatën supreme, qeverinë etj. Trupat dhe zyrtarët e huaj do ta garantonin zbatimin e marrëveshjes. Autonomia e zgjeruar do të ofrohej për një periudhë prej tre vitesh. Pas tre vitesh do të mbahej një

konferencë ndërkombëtare për të vendosur mbi statusin final të Kosovës. Kompetencat e RFJ në Kosovë do të ishin: (a) integriteti territorial; (b) ruajtja e tregut të përbashkët brenda RFJ; (c) politika monetare; (d) mbrojtja; (e) politika jashtme; (f) doganat; (g) sistemi tatimor federal; etj. Për më tepër, në Kosovë do të kishte tre nivele të autoriteteve të zbatimit të ligjit, kosovare, republikane dhe federale, kurse kufijtë ndërkombëtarë do të kontrolloheshin nga autoritetet jugosllave (rreth 1500 ushtarë). Në Kosovë do të zbankonte edhe një forcë e NATO-s si garantuese e marrëveshjes. Në përmbyllje të draft tekstit qëndronte dispozita që parashihnte organizimin e një konference ndërkombëtare për të caktuar mekanizmat për zgjidhjen e statusit final të Kosovës bazuar në vullnetin e popullit, përpjekjeve të palëve për respektimin e marrëveshjes dhe Aktit Final të Helsinkit.

Pavarësisht se premtohej një konferencë për statusin e Kosovës, një formullim i tillë, ku theksohej ruajtja e integritetit territorial të RFJ dhe politikat e përbashkëta në sferat më të rëndësishme, ishte vështirë i pranueshëm për delegacionin shqiptar. Sekretarja amerikane e Shtetit, Madeline Albright, i dha garanci të qarta delegacionit shqiptar në Rambuje se shprehja "vullneti i popullit" nënkupton vullnetin e popullsisë në Kosovë e jo të asaj në Serbi e Mal të Zi, që do të shprehet përmes

referendumit. Delegacioni shqiptar e nënshkroi marrëveshjen, kurse serbët e refuzuan. Më 24 mars 1999, filloi fushata e sulmeve ajrore të NATO-s kundër caqeve policore e ushtarake jugosllave. Fushata zgjati 78 ditë. Në qershor 1999 gjeneralët e Millosheviqit u detyruan ta nënshkruanin kapitullimin e Ushtrisë jugosllave dhe brenda një kohe të shkurtër forcat serbe u detyruan të tërhiqen nga Kosova, kurse në Kosovë u vendosën Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara (UNMIK), dhe KFOR-i.

Në tërë Kosovën periudha para dhe gjatë bombardimeve të NATO-s ishte e shoqëruar me beteja të rrepta ndërmjet forcave ushtarake, policore e paramilitare serbe dhe forcave të UÇK-së.

Si përfundim, mund të konstatojmë: nga të gjitha analizat del përfundimi se, faktori vendimtar për të arriturat në Kosovë ishte Lufta Çlirimtare e Kosovës, ishte UÇK-ja me dinamizmin, pjekurinë, operacionalitetin, zhdërvjelltesinë, largpamësinë, qëndrueshmërinë, unitetin, kompleksitetin dhe ndërveprueshmërinë. Të gjithë faktorët e tjerë kanë qenë faktorë ndihmës dhe mbështetës... Pra, është e qartë se pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe pa luftën e drejtë të saj, nuk do të kishte as ndërhyrje të NATO-s dhe as mbështetje të opinionit ndërkombëtar dhe organizmave evropianë e botërorë. **(Fund)**



Takohen Totaj e Minxhozi: Të rritet bashkëpunimi në turizëm dhe zhvillim ekonomik

PRIZREN, 23 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Ai gjatë këtij takimi ka theksuar se marrëdhëniet me Shqipërinë janë të një rëndësie të veçantë. "Thellimi i marrëdhënieve vëllazërore që kemi me Shqipërinë dhe bashkëpunimi

me ta mbetet prioritet yni", ka thënë Totaj, duke theksuar se të dyja palët u zotuan për bashkëpunim, njëkohësisht për iniciimin e bashkëpunimeve ndërkomunale me komunat e Shqipërisë. "Po ashtu, biseduam për rritjen e bashkëpunimeve në sektorin e turizmit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik. Prizreni

gjeografikisht lidhet ngushtë me Shqipërinë, prandaj bashkëpunimi në sektorët e lartcekur është i domosdoshëm dhe mundëson shkëmbime të vazhdueshme në mes të Prizrenit dhe komunave të Shqipërisë, duke mundësuar zhvillimin tonë të përbashkët", ka thënë Totaj.



AGK-ja dhe NDI mbajnë konferencën 'Luftimi i dezinformatave me bazë gjinore'

PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe USAID-it në Kosovë, në kuadër të Akademisë së Gazetarëve për Integritetin e Informacionit, ka organizuar konferencën "Luftimi i dezinformatave me bazë gjinore".

Xhemajl Rexha, kryetar i Bordit të AGK-së, ka ngritur nevojën e emërimit të grave në pozita vendimmarrëse në medie në mënyrë që të luftohet gjuha mizogjiniste më me efektivitet. "Mediet janë shpesh burim i përhapjes së gjuhës mizogjiniste, dhe ajo çfarë ne si AGK angazhohemi vazhdimisht është që, në fakt, ato të shërbejnë për ta denoncuar këtë gjuhë. Në këtë aspekt do të ndihmonte shumë emërimi i më shumë grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse nëpër medie në mënyrë që lufta e përbashkët kundër gjuhës mizogjiniste të jetë më efektive", ka thënë Rexha.

Ambasadorja Nancy Soderberg, drejtoreshë e lartë rezidente e

NDI-së në Kosovë, ka thënë se mizogjia përbën një nga sfidat kryesore të hapësirës informuese në Kosovë. "Mediet kanë rol të rëndësishëm në luftimin e kësaj dukurie përmes raportimit të ndjeshëm gjinor, identifikimit të gjuhës seksiste dhe ofenduese, si dhe përmes ofrimit të mundësive dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë për të gjithë", ka thënë ajo.

Ish-presidentja Atifete Jahjaga ka thënë se luftimi i dezinformatave me bazë gjinore nuk është një problem i ri në shoqëri, por që është i pranishëm tash e sa vite me radhë, e që duhet të trajtohet me shumë seriozitet nga gazetarët dhe shtëpitë mediatike. Paneli përbërës nga gazetarë, hulumtues dhe përfaqësues të organizatave, së bashku me gazetarët pjesëmarrës të Akademisë së Gazetarëve për Integritetin e Informacionit, diskutuan për problemet aktuale në medie që ndërlidhen me mizogjininë online dhe dezinformimin gjinor, si dhe praktikë më të mira për zbutjen e këtyre sfidave.

Disa nga rekomandimet e dala



nga konferenca janë si në vijim: Përfshirja e treguesve të tjerë identitarë përveç atyre burra dhe grua, përfshirja e grave më shumë në debate televizive, ndërmarrja e

veprimeve bazuar në kontekstin aktual në Kosovë për ta përmirësuar përfaqësimin dhe portretizimin e grave në medie, si dhe zhvillimi i metodave për të

identifikuar dhe minimizuar në mënyrë proaktive gjuhën seksiste në medie. Rekomandimet e plota së shpejti do të publikohen në platformat sociale të organizatës.

Komuna e Prishtinës vazhdon bashkëpunimin me Chemonics International



PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës dhe Chemonics International Inc kanë vazhduar memorandumimin e mirëkuptimit. Kjo e fundit është zbatuese e programit të qeverisjes ekonomike të USAID-it në Kosovë. Ky program parasheh zbatimin efektiv të programit për

trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe thjeshtësimin e procesit të lëshimit të lejeve ndërtimore në komunën e Prishtinës. "Bashkë me përfaqësuesin e Chemonics International, Terence Slyëka, biseduam për bashkëpunim të mëtutjeshëm për ta lehtësuar procesin e lëshimit të lejeve ndërtimore dhe të trajtimit të ndërtimeve pa leje nëpërmjet

mënyrave të ndryshme si digjitalizimi dhe trajnimi i stafit profesional. I inkurajojmë qytetarët e Prishtinës që të aplikojnë për leje të ndërtimit në mënyrë që të sigurohemi për mbarëvajtjen e këtyre proceseve me rëndësi jetike për zhvillimin e infrastrukturës së qytetit", ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.

Tre të vdekur dhe 257 raste të reja me Covid në Kosovë

Prishtinë, 23 shkurt (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve paraprake janë regjistruar tri viktima dhe 257 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja dolën pas testimit të 2 840 mostrave, që i bie se rreth 9 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me Covid-

19. Sipas raportit të MSh-së, janë shëruar edhe 593 pacientë, ndërsa raste aktive me koronavirus janë 3 057. Nga raportet e datës 23 shkurt nga klinikat Covid-19 dhe spitalet e përgjithshme në trajtim mjekësor nga Covid-19 janë 99 pacientë, 92 nga ta të konfirmuar me

Covid-19 pozitivë dhe 7 të tjerë negativë. Ndërkaq 86 pacientë janë me oksigjenerapi, 7 pacientë në Mjekim Intensiv. Deri më tani në Kosovë me dy doza të vaksinës kundër koronavirusit janë imunizuar 898 639 persona, apo 45 për qind.



Ndahen 10 milionë euro për rezervat shtetërore, përfshihen në Pakon e Ringjalljes Ekonomike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Me propozim të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të mërkurën, u plotësua Pakoja e Ringjalljes Ekonomike me një masë shtesë, masën 3.8 - Rritja e rezervave shtetërore. Miratimi i këtij vendimi është pasuar me miratimin e vendimit tjetër për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 10 milionë eurosh për masën 3.8.

U miratua, gjithashtu, propozimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për të ndarë mjete buxhetore në shumën prej 3.5 milionë eurosh për zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike për masat 1.1 - Rikthimi në punë e atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë; 1.2 - Mbështetja e të punësuarve të formalizuar; 1.3 - Mbështetja e punësimit të grave; 1.5 -

Trajnimi dhe punësimi në TI dhe 3.1 - Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin.

Qeveria, po ashtu, ka ndarë 100 mijë euro për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Masa 4.3 - Mbështetja e kulturës dhe sportit.

Ndërsa me vendim të veçantë është autorizuar Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që t'i aprovojë transferet nga nënprogrami i "Shpenzimeve të Paparashikuara" për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40 mijë eurosh. Duke u bazuar në Ligjin e Arsimit Para Universitar në Republikën e Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit është e obliguar që të sigurojë të gjitha tekstet shkollorë sikurse në gjuhën shqipe, edhe për komunitetet joshumicë në gjuhën e të cilëve organizohet mësimi në Republikën e Kosovës. Në



këtë mbledhje u miratua vendimi për ndarjen e mjeteve për pagesën e autorësisë së autorëve të teksteve të lëndëve nacionale në gjuhën turke dhe boshnjake. Me këtë vendim janë ndarë mjete në vlerë prej

78 mijë eurosh në kuadër të detyrimit ligjor për t'i siguruar tekstet shkollorë për nxënësit e klasës I-IX. Qeveria, gjithashtu, ka miratuar vendimin përfundimtar për shpronësimet për interes

publik të pronave të paluajtshme private, të cilat preken nga ndërtimi i "Shiritit për rreshtim" për hyrje të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, në zonën kadastrale të komunës së Prishtinës.

Szunyogi: Kosova t'i shqyrtojë mundësitë e reja për furnizim me energji elektrike

PRISHTINË, 23 SHKURT - Shefi i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se njerëzit në vend meritojnë qasje të përbalueshme dhe të besueshme në energjinë e gjelbër.

Szunyog në tryezën me temën "Presidenca franceze e Këshillit të Bashkimit Evropian" ka shprehur shqetësimin edhe për mungesën e kuorumit në Kuvend dhe për ecurinë e ngadaltë të akteve legjislative. "Në Kosovë, furnizimi jo i besueshëm me energji, i cili bazohet kryesisht në thëngjill, mbetet shqetësim. Ne e inkurajojmë fuqimisht Kosovën që t'i përafrojë qëllimet e saj me ato të Bashkimit Evropian dhe t'i shqyrtojë opsionet për t'i ndryshuar furnizimet me



energji. Kjo është edhe më e rëndësishme tani kur ne po përballemi edhe me krizën në Evropën Lindore. Kosova duhet të rrisë këtë përkushtim politik për ta adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat klimatike, gjithashtu

këndvështrimin e përmbljes së agjendës së gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Njerëzit në Kosovë meritojnë qasje të përbalueshme dhe të besueshme në energjinë e gjelbër. Rreziqet dhe kostot e

moskalimit në një energji të pastër për njerëzit, për mjedisin, krijimin e vendeve të punës për investime dhe ekonominë në përgjithësi, janë dhe do të jenë të mëdha", ka deklaruar Szunyog. E ambasadorja e Francës në

Kosovë, Marie Christine Butel, ka theksuar se janë aktivë në agjendën ndërkombëtare që ka të bëjë me zvogëlimin e emetimit të gazrave dhe mbrojtjen e ambientit. Po ashtu, ajo me theks të veçantë ka folur për digjitalizimin. Ajo ka thënë se Franca është e gatshme ta bëjë "Evropën digjitale". "Franca është e gatshme ta bëjë Evropën digjitale dhe ta promovojë integrimin e tregut digjital. Ambicia jonë është që ta promovojmë digjitalizimin dhe duke zbatuar edhe Ligjin për Konkurrencë", u shpreh ajo. Sipas saj, Kosova tashmë ka hedhur hapat e parë për digjitalizim. Butel ka rekomanduar që një gjë e tillë të bëhet në mënyrë sensitive, duke marrë parasysh mbrojtjen e klimës.

Klubi i Prodhuesve: Përkrahim vendimin për rezervat shtetërore, produktet të janë 'Made in Kosova'

PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës njofton se e përkrah vendimin e Qeverisë së Kosovës që rezervat shtetërore të përfshihen në Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Sipas KPK-së, pas luhatjeve të fundit të çmimeve në tregjet botërore, blerja e rezervave shtetërore

është e domosdoshme për stabilitetin e tregut vendor. "Klubi i Prodhuesve kërkon nga Qeveria e Kosovës që blerjet për rezervat shtetërore të bëhen me prodhimet vendore, pasi që konsiderojmë që Kosova prodhon mjaftueshëm produkte esenciale që të jenë pjesë e rezervave shtetërore.

Njëkohësisht me blerjen e produkteve 'Made in Kosova' përkrahën prodhuesit vendor dhe qëndrueshmëria ekonomike e vendit tonë", thuhet në njoftim. Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin që rezervat shtetërore të përfshihen në Pakon e Ringjalljes Ekonomike.



Ja sesi Vladimir Putin e ka sjellë Evropën në pragun e luftës



Nga Gideon RACHMAN
"Financial Times"

Angela Merkel e përshkroi dikur Vladimir Putinin, si një udhëheqës që përdor metodat e shekullit XIX-të në shekullin XXI-të. Ajo që donte të thoshte ish-kancelarja gjermane, ishte se udhëheqësi rus është një njeri i luftës dhe nacionalizmit, në një epokë që supozohet se është e përcaktuar nga sundimi i ligjeve ndërkombëtare dhe globalizimi. Merkel e bëri atë deklaratë pasi Rusia e aneksoi Krimenë në vitin 2014. Tani qeveritë e Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe, po paralajmërojnë se Putin është gati të nisë "luftën më të madhe në Evropë që nga viti 1945", duke nisur një pushtim shumë më të gjerë të Ukrainës, përfshirë një sulm të drejtpërdrejtë ndaj kryeqytetit të saj, Kiev.

Në fundjavën që kaloi, pjesa më e madhe e elitës së sigurisë dhe politike perëndimore u mbledh në Gjermani për Konferencën e Sigurisë në Mynih. Krahas tensionit dhe parandjenjave të këqija, një nga emocionet dominuese qe u vu re ishte mosbesimi.

Shumë diplomatë dhe politikanë, kryesisht evropianë, refuzuan ende t'i besonin njoftimeve të bazuara në të dhënat e shërbimeve sekreteve që vinin nga Anglosfera. Pikëpamja e skeptikëve ishte se në rastin më të keq, luftimet do të

mbeten të kufizuara vetëm në Ukrainën Lindore.

Ata spekulojnë se qëllimi i Putinit, është të krijojë një presion të madh politik, ekonomik dhe psikologjik, deri në pikën ku qeveria ukrainase mund të bjerë vetë, ose kur Perëndimi mund të bëjë lëshime të mëdha diplomatike ndaj Moskës.

Nga ana tjetër, ekziston një lloj tjetër mosbesimi në mesin e atyre, që janë të bindur se Putin është gati të "përparojë" dhe të nisë një pushtim të përgjakshëm në shkallë të plotë, i cili k sy qëllim rrëzimin e qeverisë ukrainase. Një politikë-bërës i nivelit të lartë, më tha se në mesin enjë bisede me homologun e tij amerikan për luftën e afërt tha: "Ne të dy ndaluan një çast dhe i thamë njëri-tjetrit: S'mund ta besojmë që po e zhvillojmë këtë bisedë!".

Dhe në fakt këto biseda përmbajnë skenarë vërtet befasues dhe shumë shqetësues. Zyrtarët perëndimorë besojnë se nëse ushtria ruse e sulmon apo rrethon Kievin, ka të ngjarë të përdorin taktikat brutale që Putin i ka përdorur më herët në Çeçeni dhe Siri.

Kjo do të nënkuptonte përdorimin masiv të artilerisë dhe fuqisë ajrore, dhe mundësinë e shaktimit të mbi 50.000 të vdekurve në radhët e ushtrisë dhe civilëve brenda një jave. Po si arritëm deri në këtë pikë? Për këtë pyetje ka përgjigje afatshkurtra dhe afatgjata.

Në terma afatshkurtër, Shtëpia e Bardhë ka qenë e bindur se lufta ishte e mundshme që para Krishtlindjeve. Që në atë kohë, energjitë e administratës Biden u fokusuan drejt përpjekjes për ta detyruar Putinin të ndryshonte mendje, duke ia bërë të qartë se do të paguante një kosto të madhe ekonomike dhe diplomatike për luftën.

Amerikanët ka qenë gjithnjë pesimistë për shanset e tyre për të pasur sukses, por gjithsesi vendosën që ta provonin. Qeveritë e SHBA-së dhe Britanisë së Madhe, besojnë se vendimi për sulmin ndaj Ukrainës, është marrë tashmë që javën e kaluar. Ata kanë shqyrtuar edhe mundësinë që rusët të kenë krijuar enkas sinjalet, sikur po përgatiten për luftë, si pjesë e një fushate presioni psikologjik. Por volumi i madh i përgatitjeve ushtarake në terren, i ka bindur ata për të kundërtën. Vendimi për të shkuar në luftë, duhet të shpërndahet në të gjithë sistemin rus. Ai s'mund të fshihet.

Edhe bisedat nervoze midis trupave ruse që besojnë se po shkojnë në luftë, po monitorohen me shumë kujdes. Besimi se lufta është e afërt, përforcohet më tej nga ngjarjet që po zhvillohen në terren: shtimi i luftimeve në Ukrainën Lindore; shtim i sulmeve kibernetike; njoftimi se trupat ruse do të vazhdojnë të qëndrojnë në Bjellorusi; dhe lajmi se Rusia po organizon stërvitje me armë bërthamore, që synon të frikësojë kundërshtarët e saj.

Siç më tha një zyrtar i lartë evropian "është një filmi të shohësh një skenar filmi të interpretuar në çdo detaj". Përpjekjet për ta parandaluar luftën po vazhdojnë. Por amerikanët besojnë se tani janë në kushtet e përpjekjeve, për ta detyruar Putinin të ndryshojë një vendim që tashmë e ka marrë. Pyetja afatgjatë se si arritëm këtu, e gjen përgjigje prapa në kohë, në konferencën e Mynihut të vitit 2007. Pikërisht atje Putin mbajti një fjalim plot mllef, duke e denoncuar rendin e pasluftës së ftohtë dhe përdorimin e fuqisë amerikane në Irak dhe në mbarë botën.

Një vit më pas, Rusia hyri në luftë në Gjeorgjinë fqinje. Në vitin 2014, ndodhi sulmi i parë në Ukrainë dhe aneksimi i Krimësë. Udhëheqësit perëndimorë, e kërcënuan Rusinë me atë që Merkel e quajti "një dëm kolosal ekonomik dhe politik".

Por Rusia i përballoi sanksionet, dhe në vitin 2018 organizoi me suksesin botërorin e futbollit. Nëse tani ai është gati të shmangë kërcënimet e sanksioneve perëndimore, kjondodh sepse ai i ka dëgjuar edhe më parë të gjitha ato.

Por një sulm në shkallë të plotë ndaj Ukrainës, do të përfaqësonte një përshkallëzim të madh edhe në raport me gatishmërinë e tij për të përdorur forcën, si dhe për të pranuar konfrontimin me perëndimin. Pas më shumë se 20 vitesh në pushtet, dhe duke qenë në moshën 69-vjeçare, ai mund të

jetë tani duke e marrë me çështjen e trashëgimisë që do të lërë pas.

Putin ka shprehur një dëshirë të madh për të "ribashkuar" Russkiy Mir, botën ruse, e cila, siç e sheh ai, është sot e ndarë. Rikthimi i Ukrainës në orbitën e Moskës, mund të shihet si përfundimi i një detyre historike.

Nëse mendon vërtet si një udhëheqës i shekullit XIX-të, Putini do të besojë se njëgjakderdhje e madhe është e justifikuar për ta bashkuar kombin. Në fund të fundit, ushtria e Abraham Lincoln e dogji Atlantën në vitin 1864 për të ruajtur unitetin e SHBA-së. Otto von Bismarck zhvilloi 3 luftëra për të bashkuar Gjermaninë, dhe është ende subjekti i biografive me tone admiruese.

Megjithatë, shumë analistë, përfshirë liberalët rusë, besojnë se Putinin e gënjen mendja në mënyrë të rrezikshme, nëse beson se këto lloj luftërash janë ende të mundura në Evropë.

Sot, çdo mizori e kryer nga forcat ruse do të regjistrohet në smartfonin e dikujt, dhe do të transmetohet në mbarë botën.

Të rinjtë rusë gëzojnë të njëjtat liri teknologjike dhe sociale si bashkëkohësit e tyre në Evropën Perëndimore. A do t'i pranajnë ata rreziqet, privimet dhe gabimet morale që mund të imponojë Putini? Pra me pak fjalë: A mundet ai të vazhdojë të përdorë metodat e shekullit XIX-të në shekullin XXI-të? Këtë mund ta zbulojmë shumë shpejt. /Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Giresse: Jam i nderuar që do ta drejtoj Kosovën

Strategu francez Alain Giresse është paraqitur trajner i Kosovës të mërkurën nga kryetari i FFK-së, Agim Ademi. Ai ka shprehur nderim që do të jetë në krye të “dardanëve” derisa ka nënshkruar kontratë deri në nëntor të vitit 2023. “Me kënaqësi kam pranuar të jem këtu pasi kam njohuri për Kosovën. Unë jam pajtuar me kërkesat e kryetarit të FFK-së, pasi kam punuar më përpara me ekipe kombëtare dhe e di që çdo vend pret shumë prej ekipit të tij”, ka thënë Giresse



Giresse mirëseardhje te Kosova dhe suksese të mëdha”, ka thënë Ademi. Ndërsa Alain Giresse ka shprehur nderim që i është besuar detyra e përzgjedhësit të Kosovës. Ai foli edhe për ish-kryetarin e FFK-së, Fadil Vokrri, me të cilin ka thënë se kishte raporte shumë të mira. “Jam i lumtur e shumë i nderuar që sot po zyrtarizohet detyra ime përzgjedhësi i Kosovës. Unë jetoj në Toulouse dhe atje kam miq kosovarë. Para disa vjetëve isha mysafir në Kosovë. Ky kryetari aktual nuk ishte në atë

post, por i ndjeri Fadil Vokrri, për të cilin dua ta bëj një homazh këtu për shkak se kam pasur lidhje shumë të forta me të. Në Francë, kur kam dëgjuar për vdekjen e tij, kam mbetur shumë i prekur. Për të vazhduar lidhjen time me Kosovën, kur isha në krye të Senegalit, kemi luajtur një miqësore me Kosovën në Gjenevë. Në atë kohë Kosova nuk ishte e pranuar në UEFA dhe në Senegal më kanë pyetur se kundër kujt do të luajmë dhe u kam treguar se bëhet për një vend që e njoh shumë mirë. Kjo është lidhja ime dhe për këtë arsye me kënaqësi kam pranuar të jem këtu pasi kam njohuri për Kosovën. Unë jam pajtuar me kërkesat e kryetarit të FFK-së, pasi kam punuar më përpara me ekipe kombëtare dhe e di që çdo vend pret shumë prej ekipit të tij”, ka thënë Giresse. Strategu francez, që dikur e kishte drejtuar skuadrën e PSG-së, bëri me dije se mezi pret të fillojë punën me

“dardanët”. Giresse ka thënë se e njeh ekipin kombëtar të Kosovës dhe se pret me padurim ta fillojë punën në fushën e gjelbër. Ai konfirmoi se i pëlqen shumë se lojtarët e Kosovës janë shumë teknikë dhe u pëlqen ta mbajnë topin. “Kosova luan si ekip bashkë. Ne duhet të ndërtojmë një ekip me potencialin ekzistues të lojtarëve. Puna është bërë paraprakisht dhe unë jam këtu vetëm për ta vazhduar punën, të përparojmë dhe të bëjmë më të mirën. Lojtarët janë shumë teknikë, kanë dëshirë ta mbajnë topin, gjë që më pëlqen shumë. Mua më pëlqen stili i lojës së lojtarëve të Kosovës. Sa i përket ekipit, është me rëndësi ta gjejmë bilancin e duhur dhe mentalitetin, që është i nevojshëm për të treguar lojë të mirë”, ka shtuar ai. Giresse nis punën në miqësoret e muajit mars, ku Kosova do të luajë kundër Burkina Fasos më 24 mars dhe Zvicrës më 29 mars.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 SHKURT - Alain Giresse është përzgjedhësi i ri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Strategu francez të mërkurën është paraqitur nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, si pasardhës i Bernard Challandesit në krye të përfaqësueses “dardane”. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, në prezantimin e Giresse ka thënë se është i lumtur me emërimin e tij përzgjedhës dhe se synime të Kosovës janë

rezultatet pozitive. “Kam nderin që sot ta prezantoj trajnerin e ri, të mirënjohurin Alain Giresse. Besoj që emri i tij mjafton për të treguar se kush është. Jam shumë i lumtur që gjendet në mesin tonë dhe ka pranuar të jetë në krye të Përfaqësueses së Kosovës. Me të do t'i futemi sfidës për të pasur sa më shumë rezultate të mira. I kemi garantuar dhe i kemi dhënë përkrahjen e plotë për ta vazhduar punën dhe për të pasur rezultate të pritura. Besoj se me të do ta arrijmë synimin që e kemi pasur deri më tani. Unë i uroj trajnerit

Drita fiton ndeshjen ndaj Malishevës, s'gabojnë Ballkani dhe Llapi

Drita, Ballkani dhe Llapi nuk kanë lejuar befasi dhe kanë marrë pikët e plota nga përballjet me Malishevën, Ulpianën dhe Feronikelin. “Nikli” është pajtuar se do të largohet nga Superliga, derisa garën për mbijetesë do ta vazhdojnë Malisheva dhe Ulpiana. Tri skuadrat që të mërkurën arritën fitore do të luftojnë për titull



solli gjashtë gola. Vendasit morën pikët e plota, pasi fituan me rezultat 4-2 ndaj juniorëve të Feronikelit. Golat i shënuan Alef Firmino, Maliqi, Amadu dhe Bianor Neto, ndërsa për mysafirët shënuan Seferi dhe Kiqina. Llapi vazhdon të jetë në pozitën e katërt me 36 pikë, ndërsa “Nikli” mbetet në vendin e fundit me 11 pikë.

Sot dy ndeshje në Superligë

Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshje interesante në Superligën e Kosovës në futboll. Gjilani synon fitoren kundër Dukagjinit dhe të rikthehet në pozitën e dytë në renditjen

SUPERLIGA - Java 21

Malisheva - Drita	1-2
Ballkani - Ulpiana	3-0
Llapi - Feronikeli	4-2

Të enjten takohen:
13:00 Gjilani - Dukagjini
13:00 Drenica - Prishtina

TABELA

1. Ballkani	42 pikë
2. Drita	41
3. Gjilani	39
4. Llapi	36
5. Drenica	27
6. Prishtina	24
7. Malisheva	23
8. Ulpiana	19
9. Dukagjini	18
10. Feronikeli	11

tabelore. Skuadra nga Klina nuk po kalon nëpër formë të mirë, por do të përpiqet t'u bëjë telashe gjilanasve dhe të nxjerrin rezultat pozitiv. Ndeshje interesante pritet të zhvillohet në Skenderaj, ku Drenica e pret Prishtina. Këto dy skuadra janë në mesin e tabelës dhe të dyja synojnë të marrin fitore nga kjo përballje.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 SHKURT - Skuadra e Dritës u është rikthyer fitoreve në Superligë pasi e ka mposhtur Malishevën me rezultat 1-2. Pjesa e parë e kësaj ndeshjeje përfundoi me rezultat 0-0, kurse katër minuta pasi filloi pjesa e dytë mysafirët shënuan nëpërmjet Simonovskit. Në minutën e 61-të Astrit Fazliu shënoi nga penalltia për rezultat 0-2. Vendasit u rikthyen në lojë dhe shënuan dhjetë minuta para fundit me anë të Marc-Olivier, por kjo ishte e tëra që arritën në këtë ndeshje. Me tri pikët e reja Drita

ngrehet në vendin e dytë me 41 pikë, kurse Malisheva është në vendin e shtatë me 23 pikë. Në ndeshjen tjetër Ballkani fitoi pa problem të madh ndaj Ulpianës (3-0). Skuadra mysafire u mbajt vetëm deri në minutën e 42-të, kur Edvin Kuç realizoi golin e parë. Në minutat shtesë të kësaj pjesë Blend Baftiu e shënoi golin e dytë. Ndërsa për rezultat final 3-0 u përkujdes Mevlan Zeka. Pas kësaj ndeshjeje Ballkani i Ilir Dajës e ruan pozitën e parë me 42 pikë, kurse Ulpiana është e teta me 19 pikë. Ndeshja në mes të Llapit dhe Feronikelit, e zhvilluar në stadiumin “Zahir Pajaziti”, ishte fantastike dhe

Fillojnë punimet në tribunën lindore të stadiumit të 2 Korrikut

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kanë filluar punimet në tribunën e stadiumit të 2 Korrikut në Prishtinë. Lajmin e ka bërë dhënë drejtori i Sportit në

komonën e Prishtinës, Granit Rugova, nëpërmjet një shkrimi të publikuar në llogarinë e vet në “Facebook”. “Fillojnë punimet në

tribunën lindore të stadiumit të 2 Korrikut në Arbëri. Tribunë e cila është e nevojshme për t'i plotësuar kushtet e zhvillimit të

ndeshjeve të Superligës së Kosovës dhe aktiviteteve ndërkombëtare për gjeneratat e reja”, ka shkruar Rugova.



LeBroni prit të largohet nga Lakersi

Los Anxhelos, 23 shkurt - Gjatë fundjavës së All-Star kishte disa shenja se LeBron Jamesi mund të largohet nga Los Angeles Lakersi. Jake Fischer i Bleacher Report bëri analizën më të saktë të situatës aktuale dhe parashikoi pak a shumë

rezultatit që të gjithë tifozët e Lakersit i tremben. Ai deklaroi se nëse LeBron Jamesi nuk nënshkruan një rinovim të kontratës deri në verën e vitit 2022, "Mbreti" mund të largohet. Jamesi është ende i lidhur me një kontratë që do ta mbajë atë në Lakers deri në

fund të sezonit 2022-23. Mes të gjitha deklaratave për të ardhmen e tij gjatë fundjavës All-Star, ka pak shpresë që ai të qëndrojë pas atij viti të fundit në kontratën e tij. Aktualisht Lakers është ekipi i 9-të në Konferencën Perëndimore dhe është në

rezik për të luajtur në "play-in" deri në përfundimin e sezonit të rregullt. Pas fitimit të titullit të vitit 2020, Lakers nuk ka qenë në gjendje të kthehet në rrugët e fitoreve me LeBron Jamesin që ende performon në nivelin më të lartë. Kjo padyshim që e



frustron yllin pasi ai po jep shifra fantastike pavarësisht se sapo ka mbushur 37 vjeç.

Zbulohen hollësi të tjera për vdekjen tragjike të Emiliano Salas

LONDËR, 23 SHKURT - Më 21 janar të vitit 2019 fluturimi i Emiliano Salas u zhdruk mbi kanal in anglez derisa ai ishte rrugës për të nënshkruar për Cardiff City nga Nantes. Përfundimisht mbetjet e avionit u gjetën në deti, duke përfshirë ato të kapitenit të fluturimit dhe futbollistit argjentinas. Kjo mbetet një nga tragjeditë më të mëdha që ka ndodhur në futboll vitet e fundit, dhe tashmë janë zbuluar hollësi të reja nga kjo tragjedi. Sipas "The Mirror", Sala vuajti nga helmimi me monoksid karboni përpara se të vdiste në aksident, sipas gjetjeve të bëra nga doktori i njohur Basil Purdue. Siç vë në dukje Purdue, Sala ka qenë "thellësisht i pavetëdijshëm" në pikën e përplasjes me detin, përpara se të vazhdonte të shtonte se testet toksikologjike në mostrat e gjakut të 28-vjeçarit treguan një nivel të ngopjes së gjakut me monoksid karboni prej 58-përqindësh, të cilën e cilësoi si "helmim i rëndë". Cardiff City nënshkroi Salan nga skuadra franceze Nantes më 19 janar 2019 dhe i dha nënshkrimin të tyre të ri mundësinë për t'u thënë



lamtumirë shokëve të tij përpara se të bashkohej me skuadrën e atëhershme të Ligës Premierë. Argjentinas mori një avion privat për në Uells më 21 janar, por fluturimi doli nga radari vetëm 20 kilometra në veri të Guernsey dhe pikërisht në atë çast filloi shqetësimi. Më pas filloi një kërkim për aeroplanin, me mbetjet e gjetura fillimisht më 30 janar përpara se të gjitha mbetjet të

gjendeshin në shtratin e detit të Kanalit Anglez më 3 shkurt. Më 4 shkurt grupet e kërkimit gjetën trupin e pilotit dhe më 6 shkurt gjetën një trup tjetër që më vonë u konfirmua se ishte i argjentinasit Emiliano Sala. Sala u varros në Progreso, Santa Fe, Argentinë, më 16 shkurt. Ai ishte 28 vjeç kur vdiq dhe vdekja e tij shokoi botën e futbollit me shumë klube dhe lojtarë që u solidarizuan.

Eurodeputetët, kërkesë UEFA-s: Finalja e Ligës së Kampionëve të mos zhvillohet në Rusi

Shën Petersburg, 23 shkurt - Eurodeputetja gjermane Viola von Cramon i ka dërguar një letër presidentit të UEFA-s, Aleksander Ceferini, që ta anulojë zhvillimin e finales së Ligës së Kampionëve në Shën Petersburg të Rusisë pas vendimit të Putinit për pushtim të Ukrainës dhe ta përfundojë bashkëpunimin me Gazpromin rus. Në letër eurodeputetja Von Cramon së bashku me disa eurodeputetë të tjerë kanë kërkuar që Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s ta ndalë bashkëpunimin me Gazpromin rus si sponsor i UEFA-s. "Pas situatës shqetësuese dhe kërcënimit për luftë të cilat po i



provokon Rusia dhe vendimit nga presidenti Putin për t'i njohur dy rajonet separatiste në Ukrainë, ne nënshkruesit e kësaj letre u bëjmë thirrje juve personalisht dhe UEFA-s që të marrë veprime të

përshtatshme dhe konsistente. Ne ju bëjmë thirrje që të mos e konsideroni Shën Petersburgun dhe qytetet e tjera ruse si vende për gara ndërkombëtare të futbollit dhe të zgjedhni si hap të parë dhe urgjent një tjetër lokacion për finalen e Ligës së Kampionëve më 28 maj 2022. Për më tepër, ne apelojmë nga ju të organizoni një mbledhje të veçantë të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s për ta përfunduar bashkëpunimin me Gazpromin si sponsor i UEFA-s dhe t'i konsideroni sanksionet kundër zyrtarëve rusë të cilët janë bashkëkryerës në shkëlqen e ligjit ndërkombëtar", thuhet në letër.

Allegri: Më mirë një Juve i shëmtuar dhe fitues sesa humbës

Juventus nuk arriti më shumë se një barazim ndaj Villarealit. Trajneri i Juventusit, Max Allegri, u ndal përpara mikrofonave të "Mediaset" pas ndeshjes për ta komentuar takimin. "Gabimi

në golin e pësuar ishte vendimtar, e lamë Parejon në mes të zonës vetëm. Villarreali gjithmonë kërkonte të luante midis hapësirave. Te goli ishim gjashtë kundër një dhe mbetëm të shtangur. Për

pjesën tjetër patëm një ndeshje të mirë dhe patëm disa raste. Tani është bërë si finale, nuk ka zgjidhje tjetër veç fitores në ndeshjen e dytë. Vlahoviçi zhvilloi një ndeshje të mirë dhe nuk ishte e lehtë.

Si ai dhe Morata bënë mirë kundër një ekipi teknik dhe ekspert. Shpresoja të fitonim 3-0, por duhet të qetësohemi dhe të ecim hap pas hapi. Ne kërkoni gjerësi dhe kjo ndeshje duhet të luhej në këtë

mënyrë. E kishim lojën në dorë, por kur bëjmë një lojë të bukur, atëherë jemi më pak të këqij në fushë. Më mirë të kesh një Juve të shëmtuar dhe fitues sesa të bukur dhe humbës", ka deklaruar Allegri.

SHKURT

'El Clasico' zhvillohet më 20 mars

La Liga ka caktuar ditën kur do të zhvillohet "El Clasico" e dytë në këtë edicion. Më 20 mars Real Madrid dhe Barcelona do të përballen me njëri-tjetrin në shtëpinë e "Los Blancos" me fillim nga ora 21:00. Vlen të përmendet se ndeshja e parë në mes dy gjigantëve, Barcelona dhe Real Madrid, ka përfunduar me rezultat 1-2 për madrilenët. Golat për ekipin e trajnerit Carlo Ancelotti i patën shënuar David Alaba dhe Lucas Vazquez, ndërsa për Barcelonën, Sergio Aguero. Tani, me përfundimin e blaugranasve, pritët një ndryshim i madh, sidomos pas paraqitjeve të larta që kanë zhvilluar në javët e fundit.

Spalletti: Do ta kemi tifoz 'Maradonën', do të fitojmë për të


Luciano Spalletti ka folur për "Sky" në prag të ndeshjes kundër Barcelonës, e cila do të jetë ndeshja e kthimit në Napoli pasi e para përfundoi barazim. "Është gjithmonë një perspektivë e mirë. Skuadra ka një mentalitet korrekt dhe një vullnet për t'i bërë të lumtur tifozët e vet. Nesër do të ketë shumë tifozë kundër Barcelonës. Për ne janë një forcë e madhe. Pastaj ne do të kemi si tifoz atë, 'Maradonën'. Ai do të bëjë tifo nga lart për ne dhe ne do ta bëjmë maksimumin ta krenojmë. Ne nuk e kemi Maradonën në ekip, por kemi 11 lojtarë të cilët formojnë një ekip vërtet të fortë", është shprehur Spalletti.

Barça insiston për transferimin e Azpilicuetas

Barcelona po insiston për transferimin e mbrojtësit të krahut, Cesar Azpilicueta. Mediumet spanjolle kanë bërë me dije se Barcelona tashmë e ka kontaktuar Azpilicueta dhe i ka bërë ofertë zyrtare për t'iu bashkuar në verë. Bëhet me dije se Barça i ka ofruar Azpilicueta kontratë dyvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. 32-vjeçari në verë do të jetë lojtar i lirë pasi i skadon kontrata me Chelsea. Azpilicueta është pjesë e Chelseat prej vitit 2012 dhe këtë edicion po e bartë shiritin e kapitenit. Ai ka një gol e tri asistime në 31 ndeshje për londinezët.

Përshkallëzimi i situatës në Ukrainë, gara e Ruses mund të hiqet nga kalendari i Formulës 1

Ditët e fundit e gjithë bota është në ankth me situatën e krijuar në Rusi dhe mundësinë e fillimit të një konflikti me Ukrainën. Mjaft ngjarje sportive të planifikuara për t'u zhvilluar në Rusi, përfshirë edhe finalen e Ligës së Kampionëve, rrezikojnë të mos zhvillohen. Mes tyre edhe gara e Çmimit të Madh të Ruses në Formula 1, e planifikuar të zhvillohet më 25 shtator në pistën e Sochit. Në rast se situata në Rusi do të përshkallëzohet, atëherë ajo garë do të hiqet nga kalendari dhe pista e Sochit do të zëvendësohet me një pistë tjetër. Për momentin nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me anulimin e kësaj gare, por drejtuesit e Formulës 1 mund t'i reagojnë për t'i shmangur problemet. Anulimi i kësaj gare mund të ketë impakt te skuadra Haas, që ka si sponsor kryesor Uralkalin, ndërkohë që një prej pilotëve të saj është rusi Nikita Mazepin.



Drejtoria e Arsimit
05NR.183
Datë 23.02.2022

Në bazë të nenit 5, të Rregullores mbi ndarjen e bursave për nxënës dhe student të Komunës së Suharekës 01-Nr-016-7790 të datës 31.01.2019, Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores 01-nr-016-7543 të datës 29.01.2021, Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr.016-10815 të datës 21.02.2022 shpall këtë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për nxënës dhe student për vitin shkollor 2021/2022

Drejtoria e arsimit për vitin shkollor 2021/2022, shpall konkurs për **210** bursa (**130** bursa për student dhe **80** bursa për nxënës të shkollave të mesme të larta). Bursat ndahen vetëm për student dhe nxënës që janë banor të përhershëm të Komunës së Suharekës dhe që i vijnë në mesimet/studimet themelore në shkollat përkatësisht Universitetet publike të Kosovës.

Vlera e bursës për një vit akademik- shkollor do të jetë:

- Për student/e 50 € në muaj për 10 muaj
- Për nxënës /e 25 € në muaj për 10 muaj

Kushtet dhe kriterët:

- Të ketë të regjistruar vitin shkollor/akademik për të cilin jepet bursa.
- Të mos jetë shfrytëzues/e i ndonjë burse tjetër e cila dëshmohet me vërtetim nga fakulteti ku studion.
- Për kandidatët/et që janë regjistruar për herë të parë në fakultet të kenë dëshminë e suksesit të vitit paraprak (diploma dhe dëftesa e vitit të fundit të shkollës së mesme të lartë)
- Gjendja ekonomike sociale e familjes e cila dëshmohet me vërtetim nga Qendra për punë sociale.

Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve:

Fëmijët e dëshmorëve të cilët janë student dhe nxënës të shkollave të mesme të larta, do të ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, por të gjithë studentët dhe nxënësit e kësaj kategorie janë të obliguar ta sjellin vërtetimin e regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve për të cilin ndahet bursa.

Kriteret dhe prioritetet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë:

1. Nota mesatare 9.5 deri në 10.00, në fakultet, vlerësohen me 30 pikë,
2. Nota mesatare 8.5 deri në 9.49 në fakultet, vlerësohen me 20 pikë,
4. Nota mesatare 7.5 deri në 8.49 në fakultet, vlerësohen me 15 pikë,
5. Nota mesatare 7 deri në 7.49 në fakultet, vlerësohen me 5 pikë.
6. Nota mesatare 6 deri në 6.99 në fakultet, vlerësohen me 3 pikë
7. Suksesi i shkëlqyeshëm 4.5 deri në 5 në shkollat e mesme të larta vlerësohet me 25 pikë,
8. Suksesi shumë mirë 3.5 deri në 4.49 në shkollat e mesme vlerësohet me 15 pikë,
9. Suksesi i mirë 3 deri në 3.49 në shkollën e mesme vlerësohet me 8 pikë,
10. Suksesi i mjaftueshëm 2 deri 2.99 në shkollën e mesme vlerësohet me 3 pikë,
11. Për familjet që kanë 2 (dy) studentë nga e njëjta familje 10 pikë,
12. Për familjet që kanë tre student (vëllezër-motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë të tjera.
13. Për kandidatët e SHML që kanë dy nxënës nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë.
14. Për familjet që kanë tre (3) nxënës në shkollat e mesme të larta (SHML), (vëllezër -motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë.
15. Pikët e studentëve janë të vlefshme vetëm për kategorinë e studentëve dhe pikët e nxënësve llogariten vetëm për kategorinë e nxënësve të të njëjtës familje.
16. Gjendja ekonomike- financiare (rastet sociale) vlerësohen me 30 pikë.
17. Studentët/ nxënësit të cilët nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën pa kriterë të përcaktuara me rregullore, me kusht që të kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit),
18. Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë, e cila vërtetohet me certifikatë të vdekjes ose me deklaratë të bashkësisë familjare.
19. Fëmijët me dy prindërit me nevoja të veçanta me dëshmi mjekësore fitojnë bursën pa kriterë të përcaktuara me rregullore, me kusht që të kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit),
20. Fëmijët me nevoja të veçanta, ndërsa të dy prindërit janë në gjendje normale vlerësohen me 10 pikë.
21. Fëmijët me njërin prind me nevoja të veçanta dhe vetë fëmija me nevoja të veçanta vlerësohen me 15 pikë.
21. Fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe ish të dënuarve politikë, vlerësohen me 8 pikë,
19. Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së, vlerësohen me 10 pikë,
20. Studentët/et, nxënësit/et të cilët nuk kanë asnjërin prind të punësuar, e cila vërtetohet me dëshmi/vërtetim nga Enti i punësimit dhe nuk krijojnë të ardhura nga ndonjë veprimtari tjetër dobi prurëse, vlerësohen me 15 pikë, por këto pikë nuk llogariten edhe për studentët/et, nxënësit/et, të cilët marrin asistencë sociale.

22. Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 12 pikë,
23. Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 8 pikë.

24. Nga e njëjta familje mund të përfiton bursë vetëm një student/e dhe nxënës/e, pa marrë parasysh kategorinë e tyre.

25. Nxënësit/et, që kanë poentim të barabartë pas shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë nxënësit/et që kanë distancë më të largët nga institucionet shkollore.

Përfitues të bursës nuk mund të jenë këto kategori:

1. Studentët/et dhe nxënësit/et, që kanë dy prind të punësuar në institucionet publike (shtetërore).
2. Studentët/et dhe nxënësit/et, që prindërit e tyre kanë biznes të regjistruar dhe aktiv, e cila dëshmohet me vërtetim nga Qendra e regjistrimit të biznesit.
3. Përfitues i kësaj burse nuk mund të jetë studenti/nxënësi, nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e arsimit.
4. Nëse vërtetohet se studenti i cili është përfitues i bursës nga komuna, merr bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/a jo obligohet ta kthejë bursën.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Kërkesa sipas formës së përpiluar nga Drejtoria e arsimit;

- ✓ Vërtetimin se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2021/22 (origjinale);
- ✓ Certifikata e notave (origjinale);
- ✓ Vërtetimin se studenti/ja nuk është përfitues/e i/e bursës universitare;
- ✓ Ekstraktin e lindjes;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit;
- ✓ Vërtetim mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2021/22 ;
- ✓ Për studentët e regjistruar në vitin shkollor/akademik 2021/22, kopjet e vërtetuara të dëftesave dhe të diplomës së shkollës paraprake.

Afati i konkurrencimit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik, në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelen e shpalljeve, dokumentet dorëzohen sipas afatit të konkursit dhe nuk pranohet plotësim i dokumentave pas mbylljes së konkursit. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara në Komunën e Suharekës, zyra nr. 1 çdo ditë pune prej orës 8:00 derimë 16:00



(Re-advertisement) INVITATION TO TENDER

The Business Support Center Kosovo – BSKC is implementing “Support to previous returnee start-up beneficiaries through additional equipment as a response to the Covid-19 situation, and other returnees and people at risk of irregular migration through career capacity building measures”. The project is funded by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

BSKC invites Bidders to submit, free of charge, and without obligation on part of BSKC, a bid on offering Mentoring and Coaching sessions in Career Guidance and Support for 280 beneficiaries – certified from Soft-Skills Training.

Mentoring and Coaching sessions aim to support preparation and promotion of the employment profile, CV-s, motivation letters, and matchmaking/mediating for their labor market entry, to each of the successfully certified beneficiaries from training course.

Interested bidders, can send a request for Terms of Reference via email with reference number **BSKC/81262908/2022** in the subject line to **info@bsckosovo.org**.

The responsible BSKC officer will provide you with Terms of Reference within a day.

Bidders are not allowed to contact or discuss any aspect of the tender with BSKC before closing of the tender as it will lead to automatic disqualification.

Request for Terms of Reference must be sent by e-mail to info@bsckosovo.org before 04 March, 2022.

Application deadline is on 11 March, 2022 at 16:00

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe
populli!*

Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!



"Hero në luftë, Hero në paqe" – 1



"Drenica para gjyqit" – 2



"UÇK-ja para gjyqit" – 3



"Na e ban hallall, Kosove" – 4



"Edhe malet janë Kosova para gjyqit,
UÇK - 5

Murtaja e Kuqe-7
dramë, 6

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sadati Zymber Demaj, shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik Prishtinë, të lëshuar më 21.09.1992 me nr: 7624.

► Vigan Latifi, shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës fillore "Gjergj Fishta" Prishtinë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

